

STATUT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"DI'TI" Sh.P.K

Në këtë statut :

- " Ligji " është Ligji Nr . 9901 ,dt 14.04.2008 " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"
- "Statuti " Është Statuti I Shoqërisë.

Kreu I

Themelimi ,Emri , Objekti ,Kohëzgjatja ,Selia

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "DI'TI" Sh.P.K themelohet në përputhje me Ligjin Nr.9901 datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të gjitha aktet e tjera nënligjore në fuqi që rregullojnë këtë shoqëri.

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, më (01.10.2021), ne themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "DI'TI" shpk me adrese Shkoder, Lagja Bahcallek, RrugaTiranes km 1. Lagja Bahcallek, RrugaTiranes km 1.

Themeluesi i Shoqerise eshte Ortaku :

Ditmar Dragoni I ditelindjes 17.11.1992 dhe me nr. personal J21117079P me adrese ne Shkoder

Mendu Duka I ditelindjes 05.12.1981 dhe me nr. personal I11205009W me adrese Elbasan.

Neni2

Objekti

Shoqeria do të kryejë aktivitetin e poshte - shenuar :

Tregtim materiale ndertimi, elektrike .

Neni3

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë "DI'TI" Sh.P.K , do te jete për një periudhë të papërcaktuar.

Neni4

Adresa e Shoqërisë

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën : Shkoder, Lagja Bahcallek, RrugaTiranes km 1, ndodhur ne ZK 8591, nr pasurie 17/1114 DITI

Kreu II

Kapitali i Regjistruar

Neni 5

Kapitali Themeltar

1. Kapitali themeltar ,filleshtarë I shoqërisë "DITI " Sh.P.K është 2,000,000.00 (Dy Million) Leke. Pjesemarrja e themeluesve në kapitalin e Shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

Ortaku themelues Ditmar Dragoni: Zoteruesi 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 1.200.000 Lekë qëpërben 60 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ortaku themelues Mendu Duka: Zoteruesi 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 800.000 Lekë që përben 40 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 6

Zmadhimi dhe Zvoglimi i Kapitalit Themeltar

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë ,nëpërmjet emerimit nga gjykata kompetente e një Eksperti të autorizuar ,për këto contribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak ,për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvoglimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve , e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohet për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvoglimi i prek ortaket në të njëjtën masë ndaj pjeseve të kapitalit qe përfaqësojnë .

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet :

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë ;
- b) shit-blerjes;
- c) trashëgimisë ;
- ç) dhurimit ;
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj .

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve ,për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Kreu III

ORGANET VENDIM-MARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendim-marrës

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve është organ i vetëm vendim-marrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendim-marrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme :

- a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë.
- b) Ndryshimet e statutit.
- c) Emerimin dhe shkarkimin e Administratoreve.
- d) Emerimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar.
- dh)Percaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjën (c) dhe (ç) të kësaj pike.
- e) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë .
- f) Zmadhimin dhe zvoglimin e kapitalit të shoqërisë.
- g) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- h) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera të administratoreve .
- i) Riorganizimin dhe Prishjen e shoqërisë.
- j) Miratimin e rregullave procedural të mbledhjeve të Asamblesë.
- k) Çështje të tjera të parashikuara nga ligji dhe statute.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme ,në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga nje person I tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme ,e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Thirrja e Asamblese së Përgjithshme

1. Asambleja e përgjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, nese parashikohet nga statuti, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakëve, jo me vonë se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.
2. Kur asambleja e përgjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te mane vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortakët jane dakord, per te mane vendime, pavaresisht parregullsise.

Neni 10

KUORUMI

Në rastin e marrjes së vendimeve ,që kerkojnë një shumicë të zakonshme ,asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nese marrin pjese ortakët me të drejtë vote ,që zotërojnë më shumë se 30 5 të kuotave.

Ne rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje ,të cilat kërkojnë shumice të kualifikuar sipas nenit 87 te Ligjit " Per Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare " ajo mund te marrë vendime të vlefshme vetëm,nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votive,janë të pranishëm personalisht ,votojnë me shkrese,apo mjete elektronike,sipas parashikimeve te pikes 3 të nenit 88 të ketij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund te mbliidhet për shkak të mungeses së kuorumit të përmendur më lart ,asambleja mbliidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë ,me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e Vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me $\frac{3}{4}$ e votive te zotëruesve të kapitalit ,të ortakëve pjesëmarrës,për ndryshimin e statudit ,Zmadhimin ose Zvoglimin e Kapitalit të rregjistruar,shpërndarjen e fitimeve ,riorganizimin dhe prishjen e shoqërise.

Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicen e votive te ortakëve pjesëmarrës ,për çështje te tjera si:

- a) Përcaktimi i politikave tregtare të Shoqërisë
- b) Emerimin dhe shkarkimin e Administratorëve
- c) Emerimin dhe shkarkimin e Likujduesve dhe te Ekspertëve kontabel te Autorizuar
- d) Percaktimin e Shpërblimeve
- e) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga Administratoret ,perfshire pregatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurise së veprimtarise se Shoqërisë
- f) Miratimin e rregullave procedural të mbledhjeve te asamblesë.

Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR-se per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e Shoqërisë.

Neni 12
Votat e Ortakeve

(1) Në përputhje me të drejtat ose kufizimet që rrjedhin nga kuotat, çdo kuote i jep ortakut (në rastin kur është individ) të pranishëm apo përfaqësuesit të tij të autorizuar ose ortakut (në rastin kur është person juridik) i cili është i pranishëm përmes përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt, të drejtën e një vote.

(2) Asnjë ortak nuk do të votojë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve, në lidhje me kuotën e zotëruar prej tij, nëse nuk ka shlyer tërësisht detyrimet që kanë të bëjnë me këto kuote.

(3) Çdo kundërshtim në kohë për cilësinë e një votuesi do të komunikohet Kryetarit, vendimi i të cilit do të jetë përfundimtar. Të gjitha votat e pakundërshtuara në një mbledhje ose mbledhje të shtyre do të jenë të vlefshme.

Neni 13
Përijashtimi nga e drejta e Votës

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për :
 - a) Vlerësimin e Veprimtarisë së tij;
 - b) Shuarjen endonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c) Ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria ;
 - d) Dhenien ose jot e përfitimeve të reja ;
2. Kur ortakut përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar ,i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi ,ashtu si dhe ortakut ,të cilin përfaqëson.

Neni 14

Emerimi i Administratoreve

1. Asambleja e Përgjithshme zgjedh një ose disa persona fizike si Administrator të shoqërisë për një periudhë pesëvjeçare, në pajtim me parashikimet e shkronjës "c" të pikës 1 të nenit 81 dhe nenit 95 të Ligjit. Emerimet do të jenë individuale dhe sipas një vendimi të marre me shumicë të zakonshme nga Asambleja e Përgjithshme, i cili, nëse miratohet, sjell ernenimin e personit të propozuar si Administrator.
2. Administratoret e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji ,nuk mund të emërohen si administrator të një shoqërie të kontrolluar dhe anasjelltas.Çdo emerim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pa vlefshëm.
3. Kufizimet në lidhje me emerimin e Administratoreve parashikohen në pikën 2 të nenit 95 të Ligjit.
4. Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i shoqërisë.

Te dhenat e identifikimit: (Emri, Mbiemri dhe adresat):

Ditmar Dragoni I ditelindjes 17.11.1992 dhe me nr. personal J21117079P.

Dhe specimentet e nenshkrimit:

Nenshkrimi { Specimeni } _____

Neni 15

Kompetencat e Administratoreve

Administratorët kane të drejtë e detyrohen të :

- a) Kryejne te gjitha veprimet e administrimit të veprimtarise tregtare të shoqerise ,duke zbatuar politikat tregtare te vendosura nga asambleja e pergjithshme ;
- b) Te perfaqësojë shoqërinë tregtare ;
- c) Kujdeset per mbajtjen sakte e te rregullt të dokumentave dhe të librave kontabël te shoqërise;
- d) Pergatisin dhe nënshkruajne bilancin vjetor , bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe së bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve ,i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim ;
- e) Të kryej detyra të percaktuara ne ligj dhe ne statut ;
- f) **Detyra e Administratorit perfundon ne rast se:**
 1. Personi nuk eshte me Administrator sipas parashikimeve te Ligjit perfshire edhe parashikimet e pikes 6 te nenit 95 te Ligjit;
 2. Personi ndodhet ne gjendje paaftesie paguese;
 3. Personi vuan ose mund te vuaje nga çrregullime mendore;
- g) Personi jep doreheqjen nga detyra duke njoftuar shoqerine, ose ka munguar ,per me shume se gjashte muaj radhazi pa lejen e Administratoreve te tjere ne mbledhjet e Administratoreve te mbajtura gjate kesaj periudhe dhe Asambleja e Pergjithshme, me propozimin e Administratoreve, vendos ta Shkarkoje nga detyra.

Asambleja e e pergjithshme mund të shkarkoje administratorin në cdo kohe me shumice të zakonshme.Padite ,qe lidhen me shpërblimin e administratorit ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine ,rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Neni 16

Mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme

[1] Asambleja e Pergjithshme merr vendime te vlefshme vetem me arritjen e kuorumit te parashikuar nga neni 86 i Ligjit. Ortaket ose perfaqesuesit e autorizuar mund te marrin pjese nepermjet mjeteve elektronike, perfshire telekonferencen

(conference call) audio ose audio-video, ne perputhje me nenin 88 te Ligjit. Ortaket qe marrin pjese me mjete komunikimi elektronik kane te drejte te votojne neperrnjete numrit PIN qe iu eshte derguar se bashku me njoftimin per mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme.

(2) Administratoret caktojne Kryetarin e mbledhjes si edhe nje person per te mbajtur procesverbalin e saj.

(3) Nese asnje prej Administratoreve nuk deshiron te caktohet si Kryetar i mbledhjes ose nese asnje prej Administratoreve nuk eshte i pranishem per pesembjedhete minuta duke filluar nga ora e caktuar per fillimin e mbledhjes, ortaket e pranishem dhe me te drejte vote zgjedhin njerin prej tyre si Kryetar te mbledhjes.

(4) Administratori, pavaresisht se nuk eshte ortak, ka te drejten e pjesemarrjes si edhe te marre fjalen ne cdo mbledhje te Asamblese se Pergjithshme.

(5) Kryetari, me pelqimin e Asamblese se Pergjithshme te mbledhur ne perputhje me kuorumin e caktuar me ligj, mund (dhe eshte i detyruar nese kerkohet nga Asambleja e Pergjithshme), te shtyje mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme, por ne mbledhjen e dyte mund te diskutohen vetem ato ceshtje te cilat do te ishin diskutuar rregullisht nese nuk do te ishte shtyre mbledhja e meparshme. Kur mbledhja e Asamblese se Pergjithshme shtyhet te pakten katermbjedhete dite, njoftimi do te kryhet te pakten shtate Dite te Plota perpara kesaj date dhe ne te do te percaktohet ora dhe vendi i mbledhjes se shtyre dhe pershkrimi i pergjithshem i rendit te dites. Ne rast te kundert, dhenia e njoftimit nuk eshte e nevojshme.

(6) Asambleja vendos me votim te hapur me perjashtim te rastit kur perpara ose gjate deklarimit te rezultatit, nuk kerkohet ne menyren e duhur nje votim i fshehte. Votimi i fshehte mund te kerkohet nga:

Kryetari; ose

1. nje ortak ose ortaket qe perfaqesojne te pakten pese per qind te kapitalit therneltar te shoqerise. Kerkesa e bere nga nje perfaqesues i autorizuar i ortakut ka te njejten vlere me kerkesen e paraqitur nga vete ortakut,

Neni 17

Shperblimi, Perfitimet e tjera dhe Shpenzimet e Administratoreve

1. Administratoret shperblehen ne baze te skernes se vendosur nga Asambleja e Pergjithshme ne perputhje me parashikimet e nenin 97 te Ligjit.

2. Asambleja e Pergjithshme mund te parashikoje perfitime, nepermjet shperblimeve ne para, pensione, sigurime ose forma te tjera, per cdo person i cili ka qene por nuk eshte me ne detyre apo i punesuar ne Shoqeri, shoqeri te tjera te cilat jane ose kane qene shoqeri te kontrolluara ose per shoqeri paraardhese te shoqerise ekzistuese ose te filialeve te saj, ose per cdo familjar te tyre (perfshire bashkeshortin/ en, Ish- bashkeshortin/ en) ose persona te cilet jane ose ishin ne varesi te tyre, dhe mund te paguaje kontribute ne fonde te caktuara per dhenien e perfitimeve te tilla.

3. Administratoreve mund t'iu paguhen te gjitha shpenzimet e udhetimit, akomodimit dhe shpenzime te tjera ne lidhje me pjesemarrjen e tyre ne mbledhjet e Administratoreve ose te komiteteve te Administratoreve ose te Asamblese se Pergjithshme ne lidhje me permbushjen e detyrave te tyre.

Neni 18

Pergjegjesite e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht përgjegjës ndaj shoqërisë ose ndaj të tregëve ,për shkelje të ligjeve ,për shkelje të statutit ,apo për fajë të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që sjellin dëm shoqërisë ,i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen ,për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjishme të detyrimit të besnikërisë ,sipas neneve 14 ,15, 17 e 18 të ligjit " Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare " ,administrator detyrohet :

1. a) Të kryej detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi ,duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis ;
- b) Të parandalojë dhe të menjanojë rastet e konfliktit , present apo të mundshëm ,të interesave personale me ato të shoqërisë ;
- c) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm .

2. Administratori ,gjatë kryerjes së detyrës përgjigjet ndaj shoqërisë ,për çdo veprim ose mosveprim ,që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare ,me përjashtim të rasteve kur , në baze të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

Kreu IV

Dividendet dhe Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar

Neni 19

Dividendet

(1) Pas plotësimit të parashikimeve të nenit 77 të Ligjit, shoqëria me shumicë të kualifikuar të votave së Asamblese së Përgjithshme mund të deklarojë shpërndarjen e dividendeve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.

(2) Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me kuotat, të gjithë dividendet deklarohen dhe paguhen në përputhje me shumën e paguarë për kuotat për të cilët paguhet dividendi. Të gjithë dividendet pjesëtohen dhe paguhen në përpjesëtim të drejtë me shumën e paguarë për kuotat, pjesës ose pjesëve të periudhës për të cilën paguhet dividendi; në rast se kuota ernetohet me kushtin e përtitimit të dividendit nga një datë e caktuar, dividendi do të paguhet në përputhje me këtë kusht.

(3) Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një kuota nuk do të mbartë interesë ndaj shoqërisë nëse nuk parashikohet nga të drejtat që lidhen me kuotën.

(4) Çdo dividend që nuk është kërkuar të paguhet brenda dymbëdhjetë vjetëve nga data e maturimit, në rast se vendoset me shumicë të kualifikuar votash nga Asambleja e Përgjithshme, do të përfitohet nga shoqëria e cila nuk do të jete me e detyruar që ta paguaje atë.

Neni 20

Kalimi i Fitimeve ne Kapitalin Themeltar

Administratoret, pas vendimit te marre nga Asambleja e Pergjithshme me shumice te kualifikuar votash dhe duke pasur parasysh parimet e percaktuara ne nenin 14 te Ligjit, mund te vendosin te kalojne ne kapitalin themeltar te shoqerise fitimet e pashperndara te cilat nuk do te perdoren per te paguar dividende preferenciale apo shuma te tjera te parashikuara per rezervat e kapitalit te shoqerise.

Kreu V

Neni 21

Viti Financiare

Viti Financiare i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor . Perjashtimisht , viti i pare financiare fillon nga data e rregjistrimit ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 22

Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise ,ate vjetore dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai ngarkohet nga ana e ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiare vjetor si dhe ate per kontrolelet periodike te ushtruara.

Keto raporte ai eshte i detyruar qe keto raporte duhet t'ja paraqese ne kohe ortakeve per ti shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

Kreu VI

Prishja dhe njoftimet

Neni 23

Prishja dhe likuidimi

Ne rast te likuidimit te shoqerise, likuiduesi, ne perputhje me Ligjin dhe me vendimin e marre me shumicen e kualifikuar se votave te Asamblese se Pergjithshme, mund te shperndaje ne dobi te ortakeve te gjithe ose nje pjese te vleres se pasurive te shoqerise dhe per kete qellim, mund te vleresoje cdo pasuri dhe te percakrojë rrenyren e shperndarjes midis ortakeve te shoqerise.

Neni 24

Njoftimet

(1) Njoftimet e kryera nga cdo person sipas parashikimeve te Statutit, duhet te jene me shkrim ose (nese zbatohet) nepermjet komunikimit elektronik ne adresen e parashikuar sipas pikes 3 te nenit 4 te ketij

Statuti dhe janë të vlefshme në lidhje me kohën e njoftuar për këtë qëllim dhe personin që kryen njoftimin.

(2) Shoqëria mund të njoftojë një ortak personalisht ose duke e dërguar njoftimin me leter porosi me kthim përgjigje në adresën e regjistruar të ortakut ose në adresën apo postën elektronike (nëse ka) që i është njoftuar shoqërisë nga ortaku. Kur ka disa bashkëzotues të një kuote, të gjitha njoftimet i jepën përfaqësuesit të tyre të përbashkët në përputhje me pikën 2 të nenin 72 të Ligjit.

Neni 25

Riorganizimi i Shoqërisë bashkimi – ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblese së Ortakeve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Neni 26

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat ligjore të legjislacionit Shqiptarë.

Për sa parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Kodi Civil dhe çdo ligj tjetër specifik në R.Shqipërisë.

Neni 27

Mosmarreveshjet

Për mosmarreveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij Statuti si dhe për çdo mosmarreveshje që mund të lindë mes shoqërisë dhe të tregtarëve do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

O R T A K E T

I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

*** DI'TI* shpk**

Emer Mbiemer

**Ditmar Dragoni
Mendu Duka**

